



ALBANIAN A1 – HIGHER LEVEL – PAPER 1
ALBANAIS A1 – NIVEAU SUPÉRIEUR – ÉPREUVE 1
ALBANÉS A1 – NIVEL SUPERIOR – PRUEBA 1

Monday 8 May 2000 (morning)

Lundi 8 mai 2000 (matin)

Lunes 8 de mayo del 2000 (mañana)

4 hours / 4 heures / 4 horas

INSTRUCTIONS TO CANDIDATES

- Do not open this examination paper until instructed to do so.
- Section A: Write a commentary on one passage.
- Section B: Answer one essay question. Refer mainly to works studied in Part 3 (Groups of Works); references to other works are permissible but must not form the main body of your answer.

INSTRUCTIONS DESTINÉES AUX CANDIDATS

- Ne pas ouvrir cette épreuve avant d'y être autorisé.
- Section A : Écrire un commentaire sur un passage.
- Section B : Traiter un sujet de composition. Se référer principalement aux œuvres étudiées dans la troisième partie (Groupes d'œuvres) ; les références à d'autres œuvres sont permises mais ne doivent pas constituer l'essentiel de la réponse.

INSTRUCCIONES PARA LOS ALUMNOS

- No abra esta prueba hasta que se lo autoricen.
- Sección A: Escriba un comentario sobre uno de los fragmentos.
- Sección B: Elija un tema de redacción. Su respuesta debe centrarse principalmente en las obras estudiadas para la Parte 3 (Grupos de obras); se permiten referencias a otras obras siempre que no formen la parte principal de la respuesta.

SEKSIONI A

Shkruani nje koment te shkurter per pasazhin e meposhtem.

1. (a)

KOSOVA

Une biri yt, Kosove, t'i njoh deshirat e heshtura,
T'i njoh enderrat, ererat e fjetura mbi shekuj.

T'i njoh vuajtjet, gezimet, vdekjet
T'i njoh lindjet e bardha, caqet e tua te kalluara;

5 ta di gjakun qe te vlon ne gji,
dallgen kur te rreh neteve t'pagjumta
e te shpertheje do si vullkan -
me mire se kushdo tjetër te njoh. Kosove,
une, biri yt.

10 Ka rene dege e thyer prej reje ne trupin tend te
shituar. Kosove.

Konaqet e tua deri ne themel po rrenohen,
E pertej dhimbjes do britje shemben me ballin tim
Me krahet e zogut tim te vrare, me dashurine e
15 Njerezve te mi te kallur etjeje

Rreth trupit tend si gjarper mbeshtjelle jam,
vatrat e shkimbura per t'i perflakur,
duar e kembe t'i lidh me lemshin e perrallave te tua-
se s'te leshoj gjalle me gjak, pa te lare pellembe per
20 pellembe, eshtra e jete ne ty pa i lene.

Zgjohu, Kosove ! Zgjohu, nena ime e dashur;
balli dhe emri im i shkelur.
Zgjohu, oj ! A po e ndien vajin tim?
A po e sheh si t'i kam ngulur syte
25 mu ne zemer, mu ne shpirt,
si t'I kam hedhur duart rreth belit
per te perqafuar une, ashti yt?
Zgjohu Kosove !

Nga deget e mia te thyera kush po dahet,
30 Kete cater kush po e le ?
Ç'jane keto gjurme gjaku qe po shtohen

neper fytren tende,
keto varre e murana qe po sillen verdalle
rreth shtepise sime ? ...
35 Zgjohe, Kosove ! Zgdohu nena ime e dashur,
balli dhe emri im i shkelur,
Zgjohe, Kosove ! ...
Sonte vetem mbeta e
Ne dere t'oborrit askush me s'po me troket,
40 askush me, thua vdekur jam e harruar
ne keto troje e suka gjaku.

Thua me eshte e shkrimbur hisja
E mbyllur dera e konakut...
Zgjohe, Kosove, flake e hershme e ashtit tim
45 t'percitur.
Bota ne ty le te kallet !

Ali Podrima *Hijet e nates* 1970

1. (b)

Me me rendesi sesa dyndjet veri-jugore, qe kane qene me shume dyndje fisesh, jane dyndjet perendimore-lindore, sepse, te organizuara prej shtetesh, kane ndjekur qellime te fuqise politike dhe kane zgjatur me shume. Shqiperia eshte trualli ne te cilin grindja e gjate ndermjet botes romane-perendimore dhe ballkanike-bizantine eshte shprehur ne 5 menyren me te spikatur. Pushtuesit perendimore kane per qellim sundimin mbi Gadishull me pike te fundit Kostantinopolin: Roma, Venetiku, Normanet dhe Anjou-te. Lindoret: bizantine, gote, bullgare, serbe e osmane duan te arrijne daljen politike ne Adriatik, e nganjehere, si gotet, bizantinët dhe osmanet nen Muhamedin II, duan ta perdorin Shqiperine si derrase kercimi per Itali. - Ky qendrim i ndermjeme midis Perendimit e 10 Lindjes, i bashkuar me ruajtjen e ngulur te natyres se vet etnike, i ka gdhendur Shqiperise pergjithmone fytyren e saj te veçante. Kete nuk ka mundur ta fshije as sundimi turk. Kjo shprehet ne krejt menyren e jetes, ne historine dhe ne historine kishtare, ne zakone dhe ne poezi popullore dhe artistike te popullit shqiptar. Duhet shenuar ne kete rast se Shqiperia ka qene orientuar me teper nga Perendimi sesa fqinjët e saj. Midis gjithë vendeve 15 ballkanike, edhe Rumania, me gjithë idiomën roman te saj, e paperjashtuar Dalmacia e Shqiperia, pastaj Ishujt Jonike jane vende qe kane qene te çelura direkt e me teper ndaj influences kulturore te Perendimit. Lekundja e Shqiperise ndermjet Ballkanit e Perendimit na shfaqet, pothuaj si ne Dalmaci, edhe ne pikepamje politike dhe jo me ne fund gjuhesore, ne menyre qe elementet latine kane pesuar ne te dyja keto gjuhe nje trajtim te 20 ngjashem. Perçarja e vendit ne shume krahina malesore e te ulta, te ndara shume here thellesisht njera prej tjetres, ka lindur ne Shqiperi fiset dhe i ka mbajtue gjer me sot. Fisi, forma e zgjeruar e familjes se madhe, eshte shprehja me e thjeshte e individualizmit kolektiv, i cili i pershtatet ndjenjes qe ka shqiptari per jete. Shqiperia gjendet tani brenda ne nje proces shoqeror te padukshem, te kalimit prej jetes vetjake te fisit ne jeten e 25 perbashket nacionale.

Eqerem Qabej *Shqiptaret midis perendimit dhe lindjes 1945*

SEKSIONI B

Shkruani nje ese per nje nga temat e meposhtme. Ju duhet te bazoni pergjigjen tuaj te pakten ne dy nga librat e Pjeses se trete, qe keni studiuar. Jeni te lejuar t'i referoheni librave te tjere, por keto nuk duhet te jene boshti kryesor i pergjigjes tuaj.

2. “Cilesia e vepres letrare varet nga cilesia e personazheve te vepres.” Analizojeni kete thenie ne bazen e veprave qe keni studiuar.
 3. Krahasoni qendrimet e autoreve me vlerat morale qe ato ngrejne ne veprat qe ju keni studiuar. Tregoni ne çdo rast se si keto qendime jane percjelle dhe cili ka qene efekti.
 4. Ne çfare menyre dhe me çfare mjetesh autoret e veprave qe keni studiuar tregojne se ato jane te ndergjegjshem per pergjegjsite shoqerore si shkrimtarë?
 5. Fillimi i çdo vepre eshte nje mjet i rendesishem qe mund te perdoret per zhvillimin e gjithë vepres ne menyra te ndryshme. Krahasoni menytrat me te cilat autoret e veprave qe ju keni studiuar kane perdorur fillimin e ketyre veprave si mjete efektive ne zhvillimin e veprave me te medha.
 6. Suksesi i shume veprave letrare varet ne nje shkalle te madhe ne perdorimin shume efektiv te kontrasteve nga autoret e tyre. Identifikoni dhe kerkoni menytrat ne te cilat autoret e veprave qe ju keni studijuar kane perdorur kontrastet dhe me çfare efektesh.
-